



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 78 datë 01.09.2025

PËR PËRDORIMIN E FONDIT PËR EMERGENCAT CIVILE

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 23.09.2025, mbështetur në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", nenit 4 dhe 24, Ligjit nr.68 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", VKB nr.107 datë 18.12.2024 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Përmet viti 2025", Ligji nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", Shkresës nr.1949 datë 12.11.2024 të Repartit Ushtarak Nr 4040 (Xhenjo) "Për vlerësimin e situatës në masivin shkëmbor në fshatin Petran, Bashkia Përmet", me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit për shpenzime udhëtime dhe dieta të forcave xheniere për kryerjen e ndërhyrjes special për prishjen e masiveve shkëmbore në fshatin Petran (Petran i Vjetër) në vlerën 533 000 lekë.
2. Fondet për mbulimin e këtyre shpenzimeve do të përballohen nga struktura buxhetore: 17. 01. 10910. 604. 91707AG në vlerën 533 000 lekë.
3. Sasia prej 930 litra do të mbulohet nga struktura buxhetore 00.AF135, KAP 1, 602, Kod Produkti V328AAC e parashikuar në Buxhetin e Bashkisë Përmet.
4. Baza materiale për zërat e mëposhtëm do të mbulohen nga gjendja aktuale e magazinës.

| Nr. | Emërtimi i zërit të punës | Njësia | Sasia |
|-----|---------------------------|--------|-------|
| 1   | Lubrifikant               | litra  | 20    |
| 3   | Karburant                 | litra  | 930   |

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet-Finances dhe Sektori i Mbrojtjes Civile.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).
- 7.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Aleks TANE



KRYETAR  
Anila DHIMITRI